



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 222, datë 27.7.2022

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NGRITJEN NË DETYRË NË SHKALLËT
MË TË LARTA NË PROKURORITË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 47, 48 dhe 174 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 184, germa “ç” dhe nenit 189, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të grupit të punës të ngritur me Urdhrin Nr.80/1 prot., datë 19.02.2021, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. U shpall në Tiranë, sot më 27.07.2022.

KRYETARI

Alfred Balla

